



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilaški Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial Council**

Në mbështetje të nenit 109 dhe 110 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 1.2, 1.3, 1.4, 1.6, 1.14, dhe neneve 17, 18 dhe 19 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 19 dhe 20 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit,

Me qëllim të nxjerrjes së rregullave sipas legjislacionit të zbatueshëm në bazë të cilave administrohet procesi i rekrutimit, emërimit dhe riemërimit të prokurorëve, dhe

Duke siguruar që procesi i shqyrtimit të kandidatëve për pozitat e prokurorëve të kryhet në mënyrë transparente dhe plotësisht në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut,

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) nxjerr:

**RREGULLORE Nr. 03/2013**

**PËR PROCESIN E REKRUTIMIT, EMËRIMIT DHE RIEMËRIMIT TË  
PROKURORËVE**

**KREU I**  
**DISPOZITAT THEMELORE**

**Neni 1**  
**Qëllimi dhe Fushëveprimi,**

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është caktimi i procedurave të procesit të rekrutimit, emërimit dhe riemërimit të prokuroreve.

**Neni 2**  
**Përkufizimet**

1. Termet e përdorura në këtë rregullore do të kenë kuptimin si në vijim:
  - 1.1 **Emërimi** nënkupton procesin dhe aktin e caktimit të personit në pozitën e Prokurorit i cili në datën e aplikimit për këtë pozitë nuk është duke vepruar si prokuror në sistemin prokurorial të Kosovës pas dekretimit nga Presidenti.
  - 1.2 **Riemërimi** nënkupton procesin dhe aktin e caktimit të prokurorit me mandat të përhershëm pas kalimit të suksesshëm të mandatit fillestar (tre vjeçar), pas dekretimit nga Presidenti.
  - 1.3 **Përvoja ligjore** nënkupton përvojë pune si prokuror, gjyqtar, avokat, Profesor i së drejtës, bashkëpunëtor profesional (me provim të judikaturës) ose zyrtar ligjor (pa provim të judikaturës) në një gjykatë apo prokurori, noteri, ose përndryshe zyrtar ligjor në institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit.

**KREU II**  
**PROCEDURA PËR REKRUTIM**

**Neni 3**  
**Konkursi dhe Aplikacioni**

1. Konkursi shpallet me vendim të KPK-së dhe publikohet në së paku dy (2) gazeta të përditshme me shpërndarje në tërë territorin e Republikës dhe në ueb faqen e KPK-së. Për qëllim të informimit të kandidatëve të mundshëm nga komunitetet pakicë, konkursi gjithashtu publikohet në media të komuniteteve pakicë në Kosovë, në gjuhët zyrtare që janë në përdorim në pajtim me ligjin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës.
2. Shpallja e vendeve të lira duhet të përmbajë të gjitha informatat përkatëse për çdo pozitë, duke përfshirë:

- (a) numrin e pozitive të lira për çdo nivel;
  - (b) përshkrimin e secilës pozitë;
  - (c) kriteret rreth kualifikimit për çdo pozitë;
  - (d) Informata se si do të merret aplikacioni dhe udhëzuesi për përdorimin e aplikacionit
  - (f) afatin e fundit për dorëzimin e aplikacionit, që në asnjë rrethanë nuk mund të jetë më pak se 15 ditë.
  - (e) lista e dokumenteve të kërkuara.
3. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për pozita për të cilat aplikojnë jo më vonë se data e skadimit të konkursit, përveç përjashtimeve të theksuara më poshtë. Kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacionin standard të lëshuar nga KPK dhe kopjet e dokumenteve në vijim:
- a) Certifikatën e shtetësisë së Kosovës, të sillet në datën e caktuar;
  - b) Diplomë të fakultetit juridik;
  - c) Certifikatën mbi dhënien e provimit të judikaturës;
  - d) Certifikatën të Instiutit Gjyqësor të Kosovës për rezultatet e provimit përgatitor për gjyqtarë dhe prokurorë;
  - e) Sipas nevojës, certifikatën të IGJK-së për rezultatet e provimit të arsimit ligjor pas kryerjes së Trajnimit Fillestar të Arsimit Ligjor apo dokumente lidhur me përvojën ligjore ose një certifikatë që vërteton ushtrimin e profesionit të avokatit, sipas kërkesave të vendosura me ligj.
  - f) Sipas nevojë Certifikatë që vërteton se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit apo prokurorit për së paku tri (3) vite dhe dokumente që tregojnë arsyet e përfundimit të mandatit.
  - g) Certifikatë që vërteton që nuk është i dënuar për vepër penale ashtu siç është e përcaktuar me ligjin në fuqi.
4. Të gjitha aplikacionet do të regjistrohen në zyrën e pranimit të KPK-së dhe për secilin kandidat duhet të krijohet një dosje. Kreu i Komisionit të Emërimit do të jetë përgjegjës për mbajtjen e dosjes për secilin kandidat dhe do të sigurojë kompletimin e tyre dhe përditësimin progresiv.

### **KREU III PROCESI I EMËRIMIT**

#### **Neni 4 Komisioni për Emërim**

1. KPK do të caktojë një listë të prokuroreve me mandat të përhershëm, ndaj të cilëve nuk janë shqiptuar masa disiplinore në pesë vitet e fundit dhe të cilët kanë reputacion të lartë profesional, të cilët mund të janë anëtar të Komisionit për Emërim.

2. Gjatë vendosjes për përbërjen e Komisionit për Emërim, KPK do të marrë parasysh parimin e barazisë gjinore dhe përfaqësimit të minoriteteve.
3. KPK do të miratoj listën e prokurorëve çdo tre vite.
4. Për secilën shpallje të konkursit KPK-ja në pajtim me këtë nen do të emërojë Komisionet për Emërim përkatëse, të përbërë prej tre anëtarëve.
5. Komisioni për Emërim udhëhiqet nga një anëtar i KPK-se.
6. Për kandidatët për prokurorë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Komisioni i Emërimit do të përbëhet nga dy (2) anëtarë të KPK-së, dhe një (1) prokuror nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.
7. Për kandidatët për prokurorë në Zyrën e Prokurorisë së Apelit, Komisioni i Emërimit duhet të jetë i përbërë nga: Kryetari i KPK-së, një (1) prokuror nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe një (1) prokuror nga Prokuroria e Apelit.
8. Për kandidatët për prokurorë në Prokuroritë Themelore, anëtar i Komisionit për Emërim do të jetë një (1) nga radhët e anëtarëve të KPK-së, një (1) prokuror i Prokurorisë së Apelit dhe (1) anëtar i Prokurorisë Themelore.
9. Për kandidatë për prokurorë në Prokurorinë Speciale, Komisioni për Emërim do të përbëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.
10. KPK emëron përbërjen e Komisionit për Emërim me shumicën e votave, duke emëruar edhe Kryetarin Komisionit për Emërim, për çdo konkurs të shpallur.
11. KPK cakton anëtarët rezervë, të cilët do të zëvendësojnë anëtarët në rast të konfliktit të interesit apo raste tjera të parandalimit të ushtrimit të detyrës, duke përfshirë zëvendësin e Kryetarit.
12. Anëtarët e Komisionit për Emërim, do të kompensohen nga KPK-ja në pajtim me Rregulloren e Punës së KPK-se dhe Vendimin përkatës për kompensim.
13. Një zyrtar i Njësitit për shqyrtimin e performancës së prokurorëve do të shërbejë si sekretar i Komisionit për Emërim .

### **Neni 5** **Komisioni për Rishqyrtim**

1. KPK emëron Komisionin për Rishqyrtim në përbërje të tre anëtarëve për çdo konkurs, prej të cilëve së paku një (1) anëtar do të jetë nga radhët e anëtarëve të

Këshillit Prokurorial të Kosovës, një (1) prokuror i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, dhe një prokuror nga Prokuroria e Apelit.

2. Anëtarët e Komisionit për Emërim përjashtohen të jenë pjesë e Komisionit për Rishqyrtim.
3. KPK emëron Kryetarin e Komisionit për Rishqyrtim dhe cakton anëtarët rezervë, të cilët zëvendësojnë anëtarët në rast të konfliktit të interesit apo rasteve të tjera të parandalimit të ushtrimit të detyrës, përfshirë zëvendësin e Kryetarit.
4. KPK vendos për përbërjen e Komisionit për Rishqyrtim me shumicë votash.
5. Gjatë vendosjes për përbërjen e Komisionit për Rishqyrtim, KPK do të merr parasysh parimin e barazisë gjinore dhe përfaqësimit të minoriteteve.
6. Anëtarët e Komisionit për Rishqyrtim, do të kompensohen nga KPK-ja në pajtim me Rregulloren e Punës së KPK-se dhe Vendimin përkatës për kompensim.

#### **Neni 6** **Përzgjedhja fillestare**

1. Komisioni për Emërim do të shqyrtojë të gjitha aplikacionet. Kandidatët të cilët nuk kanë dorëzuar dokumentet në bazë të nenit 3.3 të kësaj Rregullore ose siç është specifikuar në konkurs brenda afatit dhe kandidatët të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kriteret sipas nenit 19 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit nuk do të merren në shqyrtim.
2. Komisioni për Emërim do t'i njoftojë më shkrim të gjithë kandidatët për të konfirmuar pranimin e aplikacioneve dhe do ti informojë. Ata kandidatë të cilët nuk i kanë dorëzuar të gjitha dokumentet siç kërkohen me nenin 3.3 të kësaj Rregullore brenda afatit të kërkuar do të informohen se aplikacionet e tyre nuk do të merren parasysh me tutje. Informata duhet të përmbajë arsyetimin e duhur.
3. KPK-ja do të publikojë në faqen e saj zyrtare të internetit listën e kandidatëve.

#### **Neni 7** **Para-përzgjedhja e kandidatëve**

1. Komisioni për Emërim do të identifikoj në pajtim me Aneksin 1 të kësaj Rregullore kandidatët me radhitjen më të mirë të cilët kanë plotësuar kriteret për përzgjedhjen fillestare. Përcakton numrin e kandidatëve me radhitje më të mirë për t'u vlerësuar dhe verifikuar sipas Nenit 8 të kësaj Rregulloreje

2. Të gjithë kandidatët do të njoftohen me shkrim për rezultatet e tyre dhe pozitën radhitëse në fazën para përzgjedhëse. Kandidatët e identifikuar sipas paragrafit 1 do të ftohen për intervistë, nëse procesi i vlerësimit dhe verifikimit sipas Nenit 8 të kësaj Rregulloreje konfirmon që kandidatët i përmbushin kriteret e përcaktuara me nenin 19 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit. Kandidatët të cilët nuk do të ftohen për intervistim, do të mund të paraqesin kërkesë për rishqyrtim sipas nenit 12 të kësaj Rregullore.
3. Kandidatit, që është ftuar për intervistë duhet të informohet për përbërjen e Komisionit të Emërimit, dhe i kërkohet që brenda tri (3) ditëve pune pas pranimit të ftesës për intervistë të kërkojë përjashtimin e ndonjërit nga anëtarët e Komisionit për Emërim apo përjashtimin e Kryetarit në rast të paanshmërisë së dyshuar apo objektivitetit të anëtarëve apo kryetarit të Komisionit. Për përjashtimin e anëtarit të Komisionit vendos Kryetari i Komisionit për Emërim, ndërsa për përjashtimin e Kryetarit të Komisionit për Emërim vendos Kryetari i KPK-së.
4. Kandidati që ka konkurruar për dy ose më shumë pozita të nivelit të njëjtë do të intervistohet vetëm njëherë.
5. Komisioni për Emërim do të zbatojë kritere të njëjta me rastin e vlerësimit të kandidatëve.

### **Neni 8** **Verifikimi dhe vlerësimi prokurorial**

1. Procedurës së verifikimit dhe vlerësimit do t'i nënshtrohen të gjithë kandidatet që janë ftuar për intervistë sipas procedurave të vendosura në nenin 7 të kësaj Rregullore.
2. Procedura e verifikimit dhe vlerësimit përfshin vlerësimin profesional dhe personal.
3. Procedura e vlerësimit dhe verifikimit do të behet përmes verifikimit të informatave të siguruara nga kandidati, përfshirë njohuritë dhe shkathtësitë e kandidatit, performancën dhe historikun mbi të kaluarën penale.
4. Procesi i vlerësimit duhet të mbahet në pajtim me dispozitat ligjore.
5. Komisioni për Emërim do të ndihmohet nga zyrtarët e Njësitit për Shqyrtimin e Performances së Prokurorive në vlerësim dhe verifikim.
6. Kandidatët kanë të drejtë të njoftohen dhe ta shiqojnë dokumentet e mbledhura dhe draft dokumentacionin jo më herët se dhjetë (10) dhe jo më vonë se pesë (5) ditë para mbajtjes së testit me shkrim.

## **Neni 9** **Testi me shkrim**

1. Si pjesë e procesit të emërimit, kandidatëve të cilët përzgjedhen për intervistë do ju kërkohet t'i nënshtrohen testit me shkrim. Të gjithë kandidatët hyjnë në test në datën dhe kohën e njëjtë. Vlerësimi i testit me shkrim do të mbahet në baza anonime.
2. Testi me shkrim do jetë i hartuar në atë mënyrë që të merren informatat për aftësitë përkatëse të kandidatit për kriteret e caktimit të cilat janë të përkufizuara me Ligjin për KPK-në.
3. Testi me shkrim dhe vlerësimi duhet të mbahen në përputhshmëri me shabllonin e vendosur në Shtojcën 2 të kësaj Rregullore.

## **Neni 10** **Intervistimi**

1. Gjatë intervistimit do të përdoret qasje e njëjte metodologjike për të gjithë kandidatët që aplikojnë për të njëjtën pozitë. Pyetjet që do të shtrohen gjatë intervistës do të jenë standarde për të gjithë kandidatët që aplikojnë për të njëjtën pozitë. Brenda pyetjeve të së njëjtës fushë mund të përdoren një sërë pyetjesh të standardizuara. Anëtarët e Komisionit për Emërim mund të shtrojnë pyetje shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna nga kandidati.
2. Komisioni për Emërim do mund të shtrojë pyetje, duke u bazuar në informatat që i ka marrë më parë gjatë procesit të vlerësimit dhe verifikimit të kandidatëve.
3. Natyra e pyetjeve të cilat mund të përdoren gjatë intervistës duhet të përgatiten në atë mënyrë që të nxjerrën informata që janë relevante me kriteret për emërim sic parashihet në Ligjin për KPK-në.
4. Fushat e pyetjeve dhe vlerësimi i përgjigjeve në intervistë duhet të bëhet sipas shabllonit të përpiluar në Shtojcë 2 të kësaj Rregullore.

## **Neni 11** **Rangimi i kandidatëve pas intervistimit**

1. Vlerësimi në fazën e intervistimit, duke përfshirë inter alia testin me shkrim, intervistën dhe dokumentet tjera të vlerësuara, do të kryhen në bazë të shabllonit të përcaktuar në Shtojcën 2 të kësaj Rregullore.

2. Komisioni për Emërim do t'i informoj me shkrim kandidatët për rezultatin përfundimtar të arritur në fazën para-përzgjedhëse dhe atë të fazës së intervistës dhe pozitën e tyre renditëse dhe poashtu edhe për mundësinë për të paraqitur kërkesë për rishqyrtim.

### **Neni 12** **Procedura për rishqyrtim**

1. Kërkesa për rishqyrtim do të dorëzohet me shkrim te Komisioni për Rishqyrtim brenda shtatë (7) ditë pune pas pranimit të informatës më shkrim. Kërkesa mund të bazohet në arsyet si më poshtë:
  - a). Llogaritja e pikëve është bazuar në gabime materiale/faktike ose nuk ka përfshirë informacion faktik që ishte në dispozicion të Komisionit për Emërim;
  - b). Është shfaqur një gabim i rëndë procedural gjatë zbatimit të dispozitave të kësaj Rregullore;
2. Komisioni për Rishqyrtim do të konfirmojë pranimin e kërkesës për rishqyrtim brenda tri (3) ditë pune dhe do të informojë kandidatin për përbërjen e Komisionit për Rishqyrtim.
3. Kandidatit do t'i kërkohet që brenda tri (3) ditë pune pas marrjes së njoftimit për përbërjen të kërkojë përjashtimin e ndonjërit nga anëtarët e Komisionit për Rishqyrtim apo Kryetarin në rast të mungesës së paanshmërisë së dyshuar apo objektivitetit të anëtarëve apo Kryetarit të Komisionit. Për përjashtimin e anëtarit të Komisionit vendos Kryetari i Komisionit, ndërsa për përjashtimin e Kryetarit të Komisionit vendos Kryesuesi i KPK-së
4. Komisioni për Rishqyrtim do të shqyrtojë të gjitha kërkesat brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune pas skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesave.
5. Nëse kërkesa nuk është dorëzuar me kohë dhe në formën e specifikuar me këtë Rregullore, atëherë ajo nuk do të merret parasysh. Kandidatët do të informohen për refuzimin dhe arsyet për refuzim të kërkesës së tyre për rishqyrtim.
6. Komisioni për Emërim do të dorëzojë dosjen e kompletuar e të gjithë kandidatëve që kanë kërkuar rishqyrtim tek Komisioni për Rishqyrtim, varësisht prej lëndës. Komisioni për Rishqyrtim mund të vendos të thërras kandidatin i cili ka kërkuar rishqyrtim në një seancë ku kërkesa e tij/saj do të rishqyrtohet ose mund të kërkojë dëshmi ose informata tjera.
7. Pas përfundimit të vlerësimit të kërkesave për rishqyrtim, Komisioni për Rishqyrtim do të vendos nëse është pranuar apo refuzuar kërkesa për rishqyrtim. Komisioni do të informojë kandidatët përkatës për rezultatet e rishqyrtimit me një njoftim të arsyetuar me shkrim.



**Neni 13**  
**Propozimi i Komisionit për Emërim**

1. Komisioni për Emërim do të jetë i detyruar t'iu përmbahet gjetjeve të Komisionit për Rishqyrtim. Ky Komision do të ftojë kandidatin të cilit i është pranuar kërkesa për rishqyrtim duke u bazuar në llogaritje të gabueshme të pikëve dhe ka rezultuar të jetë radhitur një ndër kandidatët më të mirë për intervistë. Komisioni për Emërim mund të kërkojë prova dhe informata tjera.
2. Duke u bazuar në ri-vlerësim pas rishqyrtimit, Komisioni për Emërim do të përpilojë listën e kandidatëve për secilën pozitë për ta dorëzuar në KPK duke marrë parasysh zgjedhjen e kandidatit për pozitën e caktuar në aplikacion.
3. Numri i kandidatëve të rekomanduar nga Komisioni për Emërim të KPK-ja mund të kalojë numrin e vendeve të lira që ekzistojnë për pozitë përkatëse për të cilin kandidatët kanë aplikuar.
4. Komisioni për Emërim nuk është i detyruar që të rekomandojë kandidatë për emërim në të gjitha vendet e lira që ekzistojnë për një pozitë përkatëse. Vetëm ata kandidatë që plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj do të rekomandohen për emërim, madje edhe në qoftë se kjo rezulton në pozita të mbetura bosh.

**Neni 14**  
**Propozimet për emërim**

1. Komisioni për Emërim ia dërgon KPK-së raportin e përgjithshëm të procesit të përzgjedhjes, duke përfshirë në veçanti listën e të gjithë kandidatëve, rezultatet e pikëve dhe sipas rastit edhe kërkesën për rishqyrtim, dhe po ashtu edhe një raport gjithëpërfshirës për secilin kandidatë të rekomanduar, duke përfshirë aty së paku aplikacionin, pikët e plota nga para-përzgjedhja dhe faza e intervistës dhe sipas rastit, kërkesën për rishqyrtim, për të shpjeguar arsyet për rekomandim. Për më tepër, sipas kërkesës, anëtarët e KPK-së do të kenë qasje në të gjitha dosjet e kandidatëve.
2. Në pajtim me nenin 12 të Ligjit për KPK, seanca e KPK-së, në të cilën merret vendimi për propozimin e emërimit, duhet të jetë e hapur.
3. Anëtarët e Komisionit për Emërim të cilët janë anëtarë të KPK-së kanë të drejtë vote në KPK kur të vendoset për propozimin e emërimit të kandidatëve.
4. KPK-ja mund të kërkojë nga Komisioni për Emërim shpjegime të mëtutjeshme ose informacion shtesë.
5. KPK-ja vendos për secilin kandidat në bazë të radhës së pikëve të llogaritura. Nëse dy kandidatë arrijnë pikë të njëjta, dhe nëse njëri nga kandidatët e radhitur me pikë

të njëjta është nga pakicat, dhe/ose kandidat i gjinisë së nën-përfaqësuar, kandidati nga pakicat ose kandidati i gjinisë së nën-përfaqësuar do të ketë përparësi.

6. Në rast se kandidati i rekomanduar nga Komisioni për Emërim nuk e merr shumicën e votave nga KPK, atëherë KPK-ja do të shqyrtoj kandidatin e radhës sipas pikëve përfundimtare të llogaritura.
7. Kandidatët e rekomanduar nga Komisioni për Emërim të cilët nuk janë përfshirë në propozimin për emërim për pozitë të veçantë për të cilën kanë aplikuar dhe për të cilën janë intervistuar do të njoftohen nga KPK-ja me shkrim mbi arsyet pse kandidati nuk ishte i rekomanduar për emërim.
8. Propozimi për emërim dërgohet tek Presidenti i Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pune pas vendimit për propozimin e emërimit.

#### **KREU IV**

##### **Neni 15**

##### **Procedura për Riemërim**

1. Prokurori me mandat fillestar do të vlerësohet në përputhshmëri me Rregulloren për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve.
2. Komisioni i Vlerësimit do të dorëzojë KPK-së rekomandimin e arsyetuar për riemërimin apo mos riemërimin e një prokurori.
3. KPK-ja vendos për riemërimin apo jo të prokurorit brenda katërdhjetë e pesë (45) ditëve pas pranimit të propozimit nga Komisioni për Vlerësim, në pajtim me kriteret dhe procedurat me legjislacionin në fuqi.
4. Prokurori njoftohet me shkrim dhe me arsyetim të drejtë për vendimin.
5. KPK-ja do të dorëzojë propozimin për riemërim të Presidenti.

##### **Neni 16**

##### **Bashkëpunimi**

1. Në procedurën e parapare me këtë Rregullore, KPK do të bashkëpunojë me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe me institucionet tjera relevante.
2. Për këtë qëllim, KPK mund të nënshkruaje marrëveshje mirëkuptimi me këto institucione.

**KREU V**  
**Dispozitat përfundimtare**

**Neni 17**  
**Konflikti i interesit**

Legjislacioni mbi parandalimin e konfliktit të interesit dhe Neni 16 i Rregullores për Punën dhe Aktivitetet e Këshillit Prokurorial të Kosovës do të zbatohet përshtatshëmrisht edhe për anëtarët e Komisionit për Emërim dhe Rishqyrtim.

**Neni 18**  
**Komunikimi gjatë procedurës së përzgjedhjes**

1. Anëtarët e KPK-së dhe anëtarët e Komisionit për Emërim dhe poashtu anëtarët e Komisionit për Rishqyrtim nuk mund të kenë asnjë lloji komunikimi jo zyrtar me kandidatët, me individë ose organizata që dëshirojnë ta mbrojnë apo të japin informacion në favor ose kundër një kandidati.
2. Kandidatët duhet të përmbahen nga komunikimi jo zyrtar me anëtarët e KPK-së dhe anëtarët e Komisionit për Emërim dhe Rishqyrtim.
3. Në rast se ndonjë anëtar i KPK-së dhe anëtar i Komisionit për Emërim apo Komision Rishqyrtim vepron në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni, kjo do të trajtohet si shkelje e parimit të integritetit. Në rast se kandidati vepron në kundërshtim me nenin 18.2 të kësaj Rregullore atëherë do të merret parasysh sjellja e tij/saj gjatë procesit së vlerësimit të integritetit të tij/saj.

**Neni 19**  
**Qasja e autorizuar në të dhënat personale dhe konfidencialiteti**

1. Vetëm anëtarët e KPK-së, Komisioni për Emërim dhe Komisioni për Rishqyrtim, zyrtarët që mbështesin KPK-në në procesin e rekrutimit dhe procesit të përpilimit të propozimit për emërim apo ri-emërim mund të kenë qasje në të dhënat personale të kandidatëve.
2. Informatat personale të kandidatëve nuk do mund të qasen nga asnjë person tjetër, përveç këtyre të përmendur në paragrafin 1.
3. KPK do të ndër marr hapat e nevojshëm për të garantuar nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale, siç përcaktohet në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Të gjitha dosjet dhe arkivat do të mbahen dhe ruhen nën masa sigurie. Pas përfundimit të procesit të emërimit, disa pjesë të dosjes mund të fshihen në pajtim me kriteret e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
5. KPK, Komisioni për Emërim dhe Komisioni për Rishqyrtim, nuk do të bëjnë asnjë akt ose formë të deklarimit publik të cilat mund të ndikojnë ose dëmtojnë procesin e rekrutimit, emërimit dhe ri-emërimit.

**Neni 20**  
**Dispozitat përfundimtare**


1. Kjo rregullore shfuqizon dhe zëvendëson Rregulloren Nr. 02/2012 për Procesin e Emërimit të Prokurorëve, të datës 3 korrik 2012.
2. Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje janë Shtojca 1 dhe 2.
3. Kjo rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet me Vendim të KPK-së.

**Neni 21**  
**Hyrja në fuqi**

Rregullorja hyn në fuqi ditën e publikimit të Regullores.

Prishtinë,  
23 shtator 2013

E publikuar më:

Ismet Kabashi  
  
Kryetar i Këshillit Prokurorial të Kosovës

## Procedura e Emërimit - faza e intervistimit

Kriteret e rregulluara me ligj	Treguesit	Burimet	Llogaritja e pikëve	pikët maks.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kapacitet për të analizuar fakte dhe për të kuptuar situata, mekanizma dhe procedura komplekse</li> <li>• Kapacitet për të analizuar dhe për të zbatuar materialin kombëtar dhe ligjin procedural në faktet e dëshmuara</li> <li>• Kapacitet për të analizuar dhe për të zbatuar instrumente ligjore ndërkombëtare, në veçanti instrumente për të drejtat e njeriut</li> <li>• Kapacitet për të analizuar praktikat ligjore dhe për të interpretuar normat</li> <li>• Kapacitet për të interpretuar ligjin, të zbulojë konfliktet e ligjit dhe për të përdorur parimet themelore të teorisë ligjore</li> <li>• Afërsi për hulumtime ligjore</li> </ul> <p><b>Nenet 18.4.1 dhe 18.4.4. të Ligjit për KPIK</b>  <b>Aftësia profesionale</b> (përvoja e punës, zotësia për arsytin ligjor, aftësia dhe zotësia për analizimin e problemeve ligjore, respektin për të drejtat njerëzore</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kapacitet për të analizuar fakte dhe për të kuptuar situata, mekanizma dhe procedura komplekse</li> <li>• Kapacitet për të analizuar dhe për të zbatuar materialin kombëtar dhe ligjin procedural në faktet e dëshmuara</li> <li>• Kapacitet për të analizuar dhe për të zbatuar instrumente ligjore ndërkombëtare, në veçanti instrumente për të drejtat e njeriut</li> <li>• Kapacitet për të analizuar praktikat ligjore dhe për të interpretuar normat</li> <li>• Kapacitet për të interpretuar ligjin, të zbulojë konfliktet e ligjit dhe për të përdorur parimet themelore të teorisë ligjore</li> <li>• Afërsi për hulumtime ligjore</li> </ul>	<p>intervistimi (punimi me shkrim)                      vendimet/aktet ligjore rastësisht të dorëzuara &amp; të mbledhura                      Shpalljet                      nga ish mbikqyrësi apo vet vlerësimi</p>	<p>vlerësimi si Shkëlqyeshëm: 20                      vlerësimi si Shumë Mirë: 16                      vlerësimi si Mirë: 12                      vlerësimi si Mjaftueshëm: 8</p>	<p>•</p>
<p>Kapacitet për të sintetizuar dhe për të ardhë deri të konkludime të qarta dhe ligjerisht të arsyetuara dhe gjithëpërfshirë ***</p>	<p>Kapacitet për të sintetizuar dhe për të ardhë deri të konkludime të qarta dhe ligjerisht të arsyetuara dhe gjithëpërfshirë ***</p>	<p>intervistimi (punimi me shkrim)                      vendimet/aktet ligjore rastësisht të dorëzuara &amp; të mbledhura                      Shpalljet                      nga ish mbikqyrësi apo vet vlerësimi</p>	<p>vlerësimi si Shkëlqyeshëm: 5                      vlerësimi si Shumë Mirë: 3                      vlerësimi si Mirë: 1</p>	<p>30</p>
<p>shkathësi në të shkruar, afërsi për të siguruar saktësi, qartësi dhe uniformitet në dokumente të shkruara</p>	<p>shkathësi në të shkruar, afërsi për të siguruar saktësi, qartësi dhe uniformitet në dokumente të shkruara</p>	<p>intervistimi (punimi me shkrim)                      vendimet/aktet ligjore rastësisht të dorëzuara &amp; të mbledhura                      Shpalljet                      nga ish mbikqyrësi apo vet vlerësimi</p>	<p>vlerësimi si Shkëlqyeshëm: 5                      vlerësimi si Shumë Mirë: 3                      vlerësimi si Mirë: 1</p>	

<p><b>Nenet 18.4.5, 4.7 dhe 4.8 të Ligjit për KPK</b>  <b>Neni 19.1.5. Ligji për Prokurorin e Shtetit</b>                  integriteti personal dhe integriteti moral, sjellja jashtë zyrë, paanshmëria</p>	<p><b>Integritet (Moral)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ndërshmëria, drejtësia, pa gënjeshtria, korrektsia, besueshmëria</li> <li>• pajtueshmëri me standardet e sjelljes si brenda dhe jashtë zyrës,</li> <li>• etika, dinjiteti</li> <li>• përshitatshmëria,</li> <li>• personalitet të fortë dhe vet-kontroll</li> </ul> <p>paanshmëria</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• pa anshmëri, aktuale apo të perceptuara,</li> <li>• të vemëndshëm ndaj konfliktit të interesit,</li> <li>• resepekt për diversitetin, ndjeshmërinë e minoriteteve dhe çështjeve gjinore,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• vlerësim nga apo referenca nga ish mbikqyrësi apo kolegët</li> <li>• intervistimi</li> <li>• dokumente të mbledhura gjatë vlerësimit dhe verifikimit</li> <li>• çdo dokument tjetër i bashkangjitur nga kandidatet në aplikacionet e tyre</li> </ul>	<p>maksimum 6</p>	<p>18</p>
<p><b>Neni 18.4.1, 4.5 dhe 4.6 i Ligjit të KPK-së</b>  <b>Performanca profesionale</b> (vetëdijësimi, zell, vendosmëria, përgjegjësia, aftësia komunikuese)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndenje të përgjegjësisë</li> <li>• fleksibilitet</li> </ul> <p>mendor, kapacitet për vet-vlerësim dhe për të pranuar gabimet e veta dhe për t'i përmirësuar ato</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të këtë interesim dhe të marrë pjesë në punët e përgjithshme në vend të punës, pjesëmarrje në grupe punuese apo aktivitete tjera gjyqësore (angazhim vullnetar në aktivitete të shoqërisë civile, publikime profesionale, ligjerim,...)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• vlerësim nga apo referenca nga ish mbikqyrësi apo kolegët</li> <li>• intervistimi</li> <li>• çdo dokument tjetër relevant</li> </ul>	<p>maks 4</p>	<p>15</p>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• vendosmëria, aftësia për të vendosur në një kohë të duhur</li> <li>• disponueshmëria, angazhimi dhe vet iniciativa</li> <li>• aftësia për të kryer sasi të lartë të punëve, efikasiteti</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• vlerësim nga apo referenca nga ish mbikqyrësi apo kolegët</li> <li>• intervistimi</li> <li>• çdo dokument tjetër relevant</li> </ul>	<p>maksimum 4</p>	

<ul style="list-style-type: none"> <li>• aftësi shoqërore, mundësi për të mbështetur kolegët dhe për vepruar në mënyrë integrale, orientim-ekipor</li> <li>• aftësi ndëgjimi dhe komunikimi</li> <li>• aftësi ndëgjimi dhe komunikimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>*vlerësim nga apo referenca nga ish mbikqyrësi apo kolegët</li> <li>*intervistimi</li> <li>*çdo dokument tjetër relevant</li> <li>*vlerësim nga apo referenca nga ish mbikqyrësi apo kolegët</li> <li>*intervistimi</li> <li>*çdo dokument tjetër relevant</li> </ul>	<p>maksimum 3</p> <p>maksimum 4</p>
<p style="text-align: right;"><b>63</b></p>		

Kandidatët duhet të arrijnë 20 pikët minimale për kategorinë 'aftësi profesionale' dhe minimum 15 pikë për kategorinë 'integriteti/pavarësia/paanshmëria dhe minimum 9 pikë për kategorinë 'performancë profesionale' në mënyrë që më tutje të merren parasysh si kandidatë

**Pikët maksimale për fazën e para-përgjedhjes dhe intervistimit mund të jetë: 110 (47 nga para-përgjedhjen + 63 nga intervistimi**

## Procedura e Emërimit - para-përzgjedhja

Kriteret e rregulluara me Ligj	Treguesit	Burimet	Llogaritja e pikëve	pikët maks.
Neni 19.1.1. Ligji për Prokurorin e Shtetit Neni 18.4.1. Ligji për KPK diplomë nga universiteti (juridik (element i njohurisë profesionale)	diplomë universiteti	certifikatë të notave nga universiteti që tregon rezultatet e provimeve	me notë mesatare = 6: 1 me notë mesatare >6 deri < 7: 2 me notë mesatare nga 7 deri < 8: 3 me notë mesatare nga 8 deri < 9: 4 me notë mesatare nga 9 deri 10 = 5	5
Neni 19.1.3. Ligji për Prokurorin e Shtetit Neni 18.4.1. Ligji për KPK provimi i judikaturës (element i njohurisë profesionale)	provimi i judikaturës	certifikatë të provimit të judikaturës	0 (pasi që provimi i judikaturës nuk cakton pikë)	0
Neni 19.1.4. Ligji për Prokurorin e Shtetit Neni 18.4.1. Ligji për KPK provimi përgatitor i organizuar nga IGJK (element i njohurisë profesionale)	provimi përgatitor	* certifikatë të provimit përgatitor që tregon rezultatin * certifikatë të provimit përgatitor që nuk tregon rezultatin nëse nuk është përdorur sistemi i notimit	pikë mesatare = nga pikët minimale për të kaluar në = 2/3 e pikëve: 4 pikë mesatare > 2/3 to = 4/5 : 8 pikë mesatare nga > 4/5 deri në pikë maks: 10 pa asnjë pikë që ka rezultuar nga provimi përgatitor: 8	10
Neni 19.1.7. Ligji për Prokurorin e Shtetit Neni 18.4.1. Ligji për KPK	TFAL (pjesëmarrje në forma të organizuara të trajnimit) me vlerësim	*certifikatë që vërteton ndjekjen e TFAL-it duke treguar rezultatet për secilin kurs * certifikatë të TFAL-it që nuk tregon rezultatin nëse nuk është përdorur sistemi i notimit	pikë mesatare = nga pikët minimale për të kaluar në = 2/3 e pikëve : 8 pikë mesatare > 2/3 deri = 4/5 : 15 pikë mesatare nga > 4/5 deri në pikë maks: 20 pa asnjë pikë që ka rezultuar nga certifikata e TFAL: 15	20



<p>presëmarrje në forma të organizuara të trajnimit në të cilat është vlerësuar performanca (element i njohurisë profesionale)</p>	<p>provimin e arsimit ligjor</p>	<p>* certifikatë që tregon rezultatin e aritur në provimin e arsimit ligjor * certifikatë për provimin e arsimit ligjor pa pikë nëse nuk është përdorur sistemi i dhënies së pikëve</p>	<p>pikë mesatare = nga pikët minimale për të kaluar në = 2/3 të pikëve : 4 pikë mesatare &gt; 2/3 deri = 4/5 : 7 pikë mesatare nga &gt; 4/5 deri në pikë maks : 10 pa asnjë pikë që ka rezultuar nga certifikatë e provimit të arsimit ligjor: 7</p>	<p>10</p>
<p><b>Neni 19.1.7. Ligji për Prokurorin e Shtetit</b> <b>Neni 18.4.1. Ligji për KPK</b> 7 vite përvojë pune apo 5 vite përvojë si avokat (element i përvojës së punës dhe performancës)</p>	<p>5 vite përvojë pune si avokat (duke mos llogaritur përvojën ligjore para provimit të judikaturës dhe regjistrimit në regjistrin e judikaturës</p>	<p>certifikatë që vërteton pranimin në judikaturë dhe ushtrimin e detyrës si avokat dhe dokumente që vërtetojnë datën e fillimit dhe të mbarimit të pranimit në judikaturë certifikatë që vërtetojnë përmbajtjen e trajnimit/specializimit</p>	<p>* pavarësisht viteve të përvojës, kandidatët që kanë së paku pesë vite si avokatë: 15 * trajnime apo specializim shtesë relevante me veprimtaritë prokuroriale: maksimum 20</p>	<p>alternativisht për provimin e arsimit ligjor: 20**</p>
<p><b>Neni 19.1.8. Ligji për Prokurorin e Shtetit</b> <b>Neni 18.4.1. Ligji për KPK</b> 3 vite përvojë pune si gjyqtar apo prokuror (element i përvojës së punës dhe performancës)</p>	<p>7 vite përvojë pune në fushë juridike pas mbarimit të studimeve juridike</p>	<p>dokumente që vërtetojnë mandatin e punës (fillimin dhe mbarimin) pas mbarimit të fakultetit certifikatë që vërteton përmbajtjen e trajnimit/specializimit</p>	<p>* përvojë ligjore e së paku 7 vite në kuptimin e Nenit 2.1.3 të Rregullores: 15 * trajnime shtesë relevante me veprimtaritë prokuroriale: maks 20</p>	<p>alternativisht për provimin e arsimit ligjor: 20**</p>
<p><b>Neni 19.1.8. Ligji për Prokurorin e Shtetit</b> <b>Neni 18.4.1. Ligji për KPK</b> 3 vite përvojë pune si gjyqtar apo prokuror (element i përvojës së punës dhe performancës)</p>	<p>3 vite përvojë pune si gjyqtar apo prokuror</p>	<p>vendimi i Presidentit të Kosovës që tregon fillimin dhe mbarimin e mandatit si gjyqtar apo prokuror vlerësimi i performuar nga Komisioni për Vlerësim</p>	<p>* përvojë si gjyqtar apo prokuror për së paku 3 vite: 22 * trajnime shtesë relevante me veprimtaritë prokuroriale apo përvojë shtesë si avokat apo përvojë tjetër ligjore: maks 27</p>	<p>alternativisht për provimin për gatitor, P-FAL dhe provimi i arsimit ligjor :27***</p>

<p><b>Neni 18.4.1. Ligji për KPK</b> njohuri profesionale/ të kuptuarit e të drejtave të njeriut</p>	<p>trajnim në pëshkjet për të drejtat e njeriut përpos universitetit/provimit të juridikuturës/TFAL (me kohëzgjatje se paku 3 ditë) apo publikime akademike/shkencore në fushën e të drejtave të njeriut</p>	<p>certifikatë/publikim</p>	<p>maksimum 1</p>	<p>1</p>
<p><b>Neni 18.4.1. Ligji për KPK</b> përvojë pune dhe performancë duke përfshirë respektin për të drejtat e njeriut</p>	<p>përvojë pune në sektorin e të drejtave të njeriut apo aty ku të drejtat e njeriut ishin në rrezik</p>	<p>kopje të kontratës apo përshkrim të detyrave të punës apo dokumente tjara që dëshmon marrëdhëniet e punës dhe caktimin e detyrave në fushën e të drejtave të njeriut</p>	<p>maksimum 1</p>	<p>1</p>

\* Nevojiten së paku 30 pikë me qëllim që të merren parasysh më tutje si kandidatë

\*\* Kandidatët që kanë përvojë 5 vjeçare si avokat apo 7 vite përvojë ligjore, pa detyrimin për të kryer PFAL-in dhe provimin për arsimim ligjor sipas Nenit 19 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit, por në fakt ata kanë kryer PFAL-in dhe provimin për arsimim ligjor do t'iu caktohen 5 deri në 10 pikë shtesë varësisht nga rezultati i marrë në këto provime.

\*\*\*Ish gjyqtarët dhe prokurorët, që sipas Nenit 19 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit nuk janë të detyruar për të kryer provimin përgatitor, TFAL-in dhe provimin për arsimim ligjor, por megjithatë në fakt ata i kanë kryer të gjitha këto provime me sukses do t'iu japin 8 deri në 13 pikë shtesë varësisht në rezultatit e marrë në këto provime.